

PROCESVERBAL- TIPI I KONTRATËS - MALLRA

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

- 1. OBJEKTI I PROCEDURËS: “F.V Dyer druri importi cilesia e I-re ” per nevoja te Spitalit Rajonal Vlore”.**

NR. REF – 88126-11-17-2023

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT: 50421000-2
(FPP)**

FONDI LIMIT / VLERA E PRITSHME E KONTRATES : 2 587 096 lek (Dy milione e peseqind e tetedhjetë e shtatë mijë e nentëdhjetë e gjashtë) **leke pa T.V.SH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor, Spitali Rajonal Vlore, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*
- Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 vitet e fundit financiare, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të lotit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Për të rritur pjesmarrjen, për të rritur konkurrencen dhe gjithëpërfshirjen, njësia ka kërkuar që paraqitet deklaratë për plotësimin e kriterit, si kriter minimal, por gjithashtu duke i lënë mundësinë operatorëve që në cdo rast nqs e gjykojnë me të arsyeshme të sjellin edhe vërtetimin.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e publikimit të njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të lotit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është

kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e kërkuar është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2. Operatori/et ekonomik pjesëmarrës për të realizuar F.V e mallit objekt prokurimi, si dhe shërbimin e transportit duhet të ketë minimalisht të punësuar 2 punonjës të pajisur me kontrate të vlefshme pune në kohën e zhvillimit të tenderit deri në ekzekutimin e kontratës

- Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST.

Shenim: Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet : “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar duke u bazuar në pikën 4 të nenit 77 të Ligjit nr.162/2020”Per Prokurimin Publik”, në të cilën gjejmë të përcaktuar se:

1.Ne lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale ,Autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomik zotërojnë burimet e nevojshme njerezore e teknike ,si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standarti të pershtatshëm cilesie Si dhe në pikën 5/c të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”ku përcaktohet se: Pika 5. Për të provuar pershtatshmerine për të kryer veprimtarië profesionale ,kapacitetet teknike dhe profesionale Autoriteti/enti kontraktor, kërkon:Fuqinë punetore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit

3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë të paktën 1 (një) mjet transporti, me qëllim transportin e mallrave, të cilët duhet t'i ketë në pronësi ose me qira. Për sa me sipër operatori ekonomik të paraqes një deklaratë përkatëse sipas formatit të mëposhtem:

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Kapaciteti mbajtes	Statusi
1				Pronesi/qira/perdorim

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 te DST.

Shenim: Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet : “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Shenim 3.1:

Per mjetet me status perdorimi qira/hua perdorje te disponohet kontrata noteriale perkatese mes qiradhenesit dhe qiramarresit.

Shënim:Operatori ekonomik fitues duhet te sjelle kopjet e kontratatave te deklaruarra sipas tabelës nr 1, perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit sipas nenit 26,pika 6 te VKM nr.285 dt.19.05.2021 i ndryshuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimi.

- Në rast se operatori pjesmarrës nuk është prodhues, por do të përmbush kërkesat e AK me kontrata furnizimi për të gjithë artikujt ose pjesë të artikujve objekt prokurimi, atëherë këto kontrata duhet të deklarohen sipas tabelës nr 1.

Tabela 1

Nr	Emertimi I Artikullit	Prodhuesi/Distributori I autorizuar	Data e nenshkrimit te fillimit të kontratës se furnizimit	Data e perfundimit te afatit kontratës se furnizimit
1				

2				
Etj				

Shënim: Operatori ekonomik fitues duhet të sjelle kopjet e kontratatave të deklaruara sipas tabelës nr 1, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimimit sipas nenit 26, pika 6 të VKM nr.285 dt.19.05.2021 i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku shprehet rrjedhimisht se *Autoriteti Kontraktor mund të hartojë kritere në perpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës*, si dhe pika 8 e po këtij neni në të cilën është përcaktuar : *Pika 8. Autoriteti/enti kontraktor ,përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen ,mund të përcaktojë kritere të vecanta në varesi të objektit që prokurohet ,te cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës*

- Operatori ekonomik duhet të lëshojë një deklaratë për periudhën 1 vjeçare të garancisë së mallit që kërkohën të prokurohen nga data e dorëzimit të artikullit objekt prokurimi, gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin, mirembajtjen dhe shërbimin pa pagesë, të defekteve për shkak të prodhimit dhe montimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku shprehet rrjedhimisht se *Autoriteti Kontraktor mund të hartojë kritere në perpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës*, si dhe pika 8 e po këtij neni në të cilën është përcaktuar : *Pika 8. Autoriteti/enti kontraktor ,përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen ,mund të përcaktojë kritere të vecanta në varesi të objektit që prokurohet ,te cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës*

- Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë në pronësi ose në përdorim të paktën 1 (një) ambient për prodhimin ose magazinimin e mallit objekt prokurimi. Për sa me sipër operatori ekonomik të paraqes një deklaratë perkatese sipas formatit të mëposhtëm:

Nr.	Vendodhja	Statusi
1		Pronesi/qira/perdorim

Ne rastin e paraqitjes te kontrates se qirase kontrata te jete e vlefshme ne momentin e hapjes se ofertes deri ne realizimin e kontrates.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit

7. Operatori ekonomik duhet te paraqese nje deklarate me ane te se ciles merr persiper te kryeje sherbimin e transportit, montimit si dhe vendosjen neper vende te te gjithe artikujve sipas kerkeses te autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

8.Me nenshkrimin e kontrates dhe dorezimin e artikullit operatori ekonomik krahas mallit objekt prokurimi te paraqes prane AK raport testimet perkatese per cdo produkt si dhe certifikatat e konformitetit ose të cilësisë CE/ ekuivalent si dhe certifikatën e origjinës. Per kete te paraqes detyrimisht nje deklarate se cdo produkt do te shoqerohet me raportin perkatesi dhe me certifikimet perkatëse të cilat duhet të jenë sipas kërkesave/ specifikimeve të AK-së. Raport i testeve perkatëse duhet të jetë lëshuar nga organet kompetente të akredituara jo më herët se ditën e nënshkrimit të kontratës pranë AK.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar sipas standartit CE/ ose ekuivalent dhe direktivave lidhur si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.